



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT KUKËS

Nr. 311/18 Prot.

Kukës, më 12 . 09 .2025

VENDIM

Nr. 08 Date 12 . 09 .2025

**PER MIRATIMIN E RAPORTIT TE MONITORIMIT TE ZBATIMIT TE BUXHETIT
TE KESHILLIT TE QARKUT KUKES PER PERIUDHEN JANAR-GUSHT 2025**

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 date, 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore,, nenet 8/2, 9/1, 77, 83, ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH”, Ligji nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Ligji Nr. 35/2023 “Per kompetencat e caktimit te pagave, trajnimeve te tjera financiare dhe perfitimeve te te punesuarve ne institucionet e administrates publike, si dhe te pages baze minimale në shkalle vendi”, Ligjit Nr.9936 date 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise (i ndryshuar), Ligji nr.68/2017, date 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, ligjit 152/2013 “Per nepunesin civil”, ligji 7961 date 12.07.1995 “Kodi i punes (I ndryshuar)”, VKM nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”. VKM Nr.328 date 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr.421 date 26.06.2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr 325 date 31.05.2023 per miratimin e struktures se pagave, niveleve te pagave dhe shtesavete tjera mbi page te Zevendesministrit, funksionareve te kabineteve, Prefektit, Nenprefektit, Nenpunesve Civile dhe Nenpunesve ne disa institucione te administrates publike”, VKM Nr.422 date 26.06.2024 “Per nje ndryshim ne VKM Nr.326 date 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Ligjin Nr. 115/2024, “Për Buxhetin e Vitit 2025”, si dhe Vendimin e Këshillit të Qarkut Kukës nr.12 date 13.12.2024 ”Për miratimin e buxhetit të vitit 2025, Vendimin e KQK nr.01 datë 10.03.2025 “Për miratimin e planifikimit të shpenzimit të të ardhurave vjetore për vitin 2025”, Këshilli i Qarkut Kukës në mbledhjen e datës së mësipërme



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT KUKËS**

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Monitorimit të zbatimit të buxhetit të Këshillit të Qarkut Kukës për periudhën Janar-Gusht 2025, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve mbështetëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Astrit Dobrush

Miratuar me : 9 vota
Pro: 9
Kunder: 0
Abstenim : 0
Zbardhur me: 12.09.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

Nr. 311/9 Prot.

Kukës, më 01/08.2025

RAPORT MONITORIMI JANAR – GUSHT 2025

Ky raport monitorimi i IV- mujorit të dytë të vitit 2025 është hartuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 date, 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore,, nenet 8/2, 9/1, 77, 83, ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH”, Ligji Nr. 35/2023 “Për kompetencat e caktimit të pagave, trajnimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar), Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ligji 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës (I ndryshuar)”, VKM nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”. VKM Nr.328 date 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr.421 date 26.06.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 325 datë 31.05.2023 për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nënpunësve Civile dhe Nënpunësve në disa institucione të administratës publike”, VKM Nr.422 datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në VKM Nr.326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Ligji Nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, si dhe Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 12 datë 13.12.2024 ”Për miratimin e buxhetit të vitit 2025, Vendimin e KQK nr.01 datë 10.03.2025 “Për miratimin e planifikimit të shpenzimit të të ardhurave vjetore për vitin 2025” si dhe është produkt i zbatimit të politikave të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut, në sistemin fiskal dhe atë të menaxhimit të shpenzimeve dhe të ardhurave, për të ofruar shërbime më standarde sa më të larta. Në të janë shprehur nevojat, kërkesat dhe pritshmëritë në zbatim të akteve ligjore në fuqi, detyrimeve dhe supozimeve të marra më sipër nga Këshilli i Qarkut Kukës .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të IV- mujorit të dytë të vitit 2025, është raporti i dytë i zbatimit të buxhetit për vitin 2025.

Këshilli Qarkut Kukës miratoi buxhetin e vitit 2025 me Vendimin Nr.12 datë 13.12.2024, si dhe me konfirmim të prefektit të Qarkut Kukës me nr 4/15 prot ,datë 26.12.2024, Vendim i Këshillit të Qarkut për “Miratimin e planifikimit të të ardhurave vjetore për vitin 2025” Nr.01 datë 10.03.2025 me konfirmim të prefektit të Qarkut Kukës me nr 239/1 prot ,datë 20.03.2025 i cili më pasi u dërgua për çelje pranë degës së thesarit brenda afatit ligjor. Burimet e financimit për planifikimin e buxhetit në 000/lekë për vitin 2025 janë si më poshtë:

Granti, të ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm, të ardhura nga vet institucioni si dhe të ardhura nga Bashkitë në 000/lekë si më poshtë :

- ❖ Të ardhura të trashëguara nga viti 2024, **(31,141)** (fond i pa Shpenz. Në vitin 2024, të ardhura nda DAMT dhe Bashkia Has);
- ❖ Transferta e pakushtëzuar (Granti) viti 2025, **(54,657)**
- ❖ Transferta e Specifike (DAMT) fonde të deleguara për vitin 2025, **(8,253)**.

Lidhur me procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë ndërtuar struktura (EMP dhe GMS) dhe plan pune sipas kërkesave ligjore dhe rregullave të brendshme të institucionit. Gjithashtu, Sistemet e kontrollit të brendshëm monitorohen për të vlerësuar cilësinë e sistemit të performancës në kohë, monitorim ky që kryhet në vazhdimësi nëpërmjet vlerësimeve të shkëputura. Ky monitorim bëhet çdo muaj me situacionet e shpenzimeve analitike të cilat rakordohen me Degën e Thesarit Kukës .

Titullari i institucionit dhe drejtuesit e tjerë, informohen mbi shpenzimet aktuale krahasuar këto me buxhetin e planifikuar në total për çdo program analitik që ata mbajnë përgjegjësi, në mënyrë të vazhdueshme, periodike, por edhe kur kërkohen informacion prej tyre. Janë parashikuar rregulla të brendshme për zbatimin e sistemit të firmës së dyfishtë. Çdo veprim financiar para



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

ekzekutimit kontrollohet duke u mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore për sistemin buxhetor, veprime të cilat kontrollohen edhe nga Dega e Thesarit. Këto rregulla dhe procedura monitorohen rregullisht për realizimin konform rregullave të të gjitha veprimeve që rrjedhin nga zbatimi i buxhetit.

Në takimet që bëhen me personat e caktuar për menaxhimin e riskut diskutohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me risqet. Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit, kontrollit dhe monitorimit të situatave potencialisht të dëmshme për arritjen e objektivave të njësisë dhe jep garanci të arsyeshme për arritjen e këtyre objektivave. Një nga procedurat për menaxhimin e riskut, i cili vë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit tonë gjatë planifikimit të buxhetit vjetor dhe afatmesëm është procedura e derdhjes së kontributeve financiare nga njësitë vendore (bashkitë), mbështetur në nenin 38 pika 3 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Gjatë monitorimit është vërejtur që të gjitha transaksionet financiare janë kryer në përputhje me udhëzimet dhe rregullat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe zbatimi i buxhetit shkon në sinkron me limitet e vendosura nga MFE.

Gjatë kësaj periudhe 4- mujore zbatimi i buxhetit ka shkuar sipas planifikimit të bërë dhe nuk është vërejtur apo parashikuar ndonjë problem financiar.

Relacioni Shpjegues

Objektivi i përgjithshëm i buxhetit 2025 është : *“Menaxhimi i suksesshëm i transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave për vitin 2025 e cila është planifikuar dhe fokusuar më shumë në investime dhe projekte në tre Bashkite respektive Kukes, Has, Tropoje”.*

➤ Pjesëmarrja e Këshillit të Qarkut Kukës në projekte, studime e investime konkrete për hartimin e politikave të zhvillimit të rajonit dhe harmonizimin e tyre me politikat shtetërore në nivel Qarku janë disa nga çështjet kryesore të axhendës së punës së Qarkut, me:

- *Hartimin e Planit sektorial për krijimin e një platforme dhe të drejtimeve strategjike të detyrueshme për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Kukës ;*
- *Krijimin e partneriteteve për zhvillim të qëndrueshëm rajonal;*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

- *Nxitjen e bashkëpunimit ndërbashkiak dhe ndërajonal;*
- *Përmirësimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike;*
- *Përmirësimin e rolit të Qarkut dhe njësive përbërëse të tij, në procesin e Integrimit Evropian.*

- Rritja e të ardhurave të brendshme dhe përpjekjet për arkëtimin e kontributit të njësive të qeverisjes vendore (Bashkitë) me kuotën e tyre vjetore është një objektivi tjetër që bazohet në pikën 3, të neni 38 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore". Në vitet e mëparshme ky objektivi nuk është realizuar në masën 100%.
- Në vijim të këtij kapitulli do të ndalemi në çdo element të realizimit të buxhetit me përshkrimet përkatëse narrative dhe pasqyrimin në terma sasiorë në përputhje me arritjen e objektivave kryesorë dhe të treguesve të performancës.

Këshilli i Qarkut Kukës ka dy programe:

- ✚ Programi I me Kod: '01110 për Këshillin e Qarkut;
- ✚ Programi II me Kod '01160 për DAMT (Drejtoria e Tokës) .

Objektivat kryesorë të dy programve Menaxhim, Adminis më poshtë:

- Hartimi dhe monitorimi i politikave të zhvillimit rajonal
- Burime njerëzore të trajnuara për kryerjen e funksioneve
- Sigurimi i shërbimeve mbështetëse për mirëfunksionim Qarkut Kukës.

- **Likuidimi i detyrimeve financiare të Qarkut Kukës ndaj**
- **Ofrim cilësor i shërbimit të DAMT**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

Buxheti I vitit 2025 për Këshillin e Qarkut Kukës dhe DAMT janë si më poshtë:

Përshkrimi		2023	2024	2025
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	B.1	51,526	56,551	62,910
Transferta e pakushtëzuar	B.1	44,123	48,298	54,657
Transferta e kushtëzuar funksione të deleguara (DAMT)	B.2	7,403	8,253	8,253

Plani I shpenzimeve për vitin 2025 - Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat

Programet e financimit		Plani I shpenzimit per personelin 600 & 606 & 601	Plani I shpenzi meve te tjera korente 602 & 604	Plani I shpenzimi t per investime	Plani I shpenzimi t per investime	TOTALI
				231	230	
Programi I	011. Organet ekzekutive dhe legislative, Çështjet financiare dhe	35,058	15,315	33,425	2,000	85,798
Programi II	042. Bujqesi , pyjet, peshkimi dhe gjuetia(DAMT)	8,003	250			8,253
TOTALI		43,061	15,565	33,425	2,000	94,051

Siç mund të shihet më lart kemi një tendencë në rritje të buxhetit të vitit 2025 krahasuar ky me dy vitet paraardhëse, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar, transfertat specifike, trashëgim nga viti i kaluar, si dhe trashëgim pa destinacion, për të dyja programet: Administratë dhe DAMT .


Buxheti i Këshillit të Qarkut përbëhet nga 87 % Grant për KQK dhe 13%, e zë DAMT (Drejtoria e Adminstrimit dhe mbrojtjes së tokës), funksion i deleguar pranë Këshillit të Qarkut Kukës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

Kjo e paraqitur grafiksht si më poshtë:



Bazuar në historikun e shpenzimeve, nevojave të institucionit për vitin buxhetor u bë planifikimi i buxhetit duke marrë në konsideratë propozimet dhe konsultimet e grupit të punës për përgatitjen e buxhetit për vitin 2025 si dhe kërkesat e ardhura nga tre bashkitë respektive të cilat u miratuan me vendim këshilli Nr:12, Date 13.12.2024.

Gjatë hartimit të buxhetit u morën parasysh detyrimet për paga, sigurime shoqërore e shëndetsore ndaj nënpunësve të administratës, sigurimin e bazës materiale, shpenzime operative për krijimin dhe lehtësimin e kushteve gjatë punës, shpenzime për të tretët, bashkëfinancimet me tre bashkitë respektive të qarkut, si dhe për llogaritjen e shpenzimeve për lëvizjen e personelit si brenda dhe jashtë vendit .




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

PROGRAMI I

- **Planifikimi I Buxhetit (transfertë e pakushtëzuar + të ardhura) në përqindje për programin I**



Kjo shpërndarje buxheti është bërë në bazë të kërkesave që ka administrata e Këshillit të Qarkut Kukës, si dhe në bazë të kërkesave dhe projekteve të paraqitura nga tre bashkitë e Qarkut Kukës. Gjithashtu janë marrë parasysh dhe kërkesat për bashkëfinancim për tre bashkitë respektive të propozuara dhe të miratuara me Vendim Këshilli dhe konfirmuar nga Prefekti I Qarkut Kukës.

Zë i veçantë në hartimin e buxhetit të vitit 2025 ishte dhe pjesa e investimeve që për vitin 2025 zë vendin kryesor në masën 39 % që përfshin Art. 230.

Analiza e shpenzimeve të 4-mujorit të dytë të vitit 2025

- *Raporti i shpenzimeve sipas Zërave:*

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore zërat dhe realizimi (600-601) është realizuar në zbatim të strukturës organizative të punonjësve të miratuar me VKQ nr.12 datë 13.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit, strukturës dhe nivelit të pagave të Këshillit të Qarkut Kukës për vitin 2025”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

- Gjatë 4-mujorit të dytë të vitit 2025, numri mesatar i punonjësve në administratën e Këshillit të Qarkut është 13 nga këto 3 të zgjedhur dhe 10 staff.

Gjatë periudhës Janar - Gusht 2025 për Programin I janë shpenzuar **19,416 mijëra lekë**.

- **Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbimedhe realizimi, (Art.602)**, për periudhën Janar - Gusht 2025 është realizuar **3,243 mijera lekë ose 57% e planit**. Gjatë kësaj periudhe Këshilli i Qarkut Kukës ka realizuar shpenzime operative si më poshtë :

1. Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit si detyrime Taksat, Tatimet, shërbimet për të tretët, energji, ujë, telefon, posta
2. Janë Kryer e procedurat e prokurimeve për mallra, shërbime, punë për nevojat e institucionit, shërbimi i pastrimit, ruajtje ambjenteve të kqk, naftë, shërbim larje automjeteve të institucionit.
3. Krijimin e facilitetit për udhëtime pune brenda vendit me fokus rritjen e kapaciteteve të stafit dhe organizimin e evneteve social kulturore të parashikuara nga Këshilli i Qarkut Kukës.

- **Fondet për Investime dhe realizimi (Artikulli 230-231)**

Në tabelën mëposhtë janë adresuar shpenzimet bruto për çdo program sipas Buxhetit për vitin 2025.

Në 000/lekë

Nr	Programi	Plan vjetor 2025	Fakt Janar – Gusht 2025
1	Keshilli I Qarkut Kukës,Granti	54,657	19,092
2	Të ardhura të trashëguara nga viti 2024	31,141	
	TOTALI	85,798	19,092

-Për periudhën Janar - Gusht 2025 Këshilli i Qarkut Kukës ka realizuar planin ne masën **49%** për programin I (përqindja e realizimit është llogaritur me planin 8-mujor). Për sa i perket investimeve të planifikuara për vitin 2025 sqarojmë si më poshtë:

- Investimet e planifikuara për 8-mujorin e parë të vitit 2025 siç dihet në 4-mujorin e parë për arsye të ndalimit të procedurave të prokurimit publik gjatë fushatës zgjedhore u shtynë për një moment të dytë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

Gjatë 4-mujorit të dytë kanë filluar prokurimet. Kemi mbaruar procedurat e prokurimit dhe janë lidhur kontratat me operatorët ekonomik fitues për investimet

- "Rehabilitim infrastrukturës, ndriçim rrugor në NJA Golaj, Bashkia Has
- Punime mirembajtje Zyrat e ZAMT Has dhe Tropojë të Këshillit të Qarkut Kukës



Investimi I parashikuar në fshatin Shëmri ka një ndryshim pasi aktorët lokalë kanë shprehur dakortësinë për të bërë një projekt madhor që përfshin edhe segmentin e parashikuar nga ana jonë. Nisur nga kjo deri në hartimin e plotë të projektit dhe oponencës teknike përkatëse mbetet për diskutim në një moment të dytë.

Gjithashtu nga Bashkia Kukës me shkresën nr.2862 datë 18.08.2025 është kërkuar një ndryshim në projektin e fushës sportive në fshatin Bicaj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

PROGRAMI II

Këshilli I Qarkut Kukës për vitin 2025 administron dhe menaxhon fondet buxhetore të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT)

Artikulli	600	601	602	Total
Plan vjetor	6,850	1,153	250	8,253
Plan 8-mujor	4,850	913	214	5,977
Fakt/lekë	4,752	794	55	5,600
Fakt/%	98	87	26	94

Shënim: Fakt % janë llogaritur sipas planit 8-mujor për secilin zë

Objektivat kryesorë të këtij programi janë listuar si më poshtë:

- Azhornimi i hartave kadastrale pas përfundimit të dërgimit të fondit të tokës, ndryshimit të kategorisë së tokës dhe transaksioneve të pronësisë mbi tokën në MBZHRAU.
- Miratimi I të dhënave dhe përditësimi I tyre në bashkëpunim me institucionet e specializuara për të përgatitur, azhornuar informacionin gjeografik në format e hartave, të dhënave përshkruese dhe GIS për rrethin Kukës, Has dhe Tropojë.


Buxheti I DAMT është fond i deleguar dhe i planifikuar nga Ministria e linjës në formën e transfertës së kushtëzuar ku përcaktohet në mënyrë të detajuar.

Plani dhe fakti në lekë për periudhën Janar - Gusht 2025 për DAMT është si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS



Analiza e shpenzimeve të periudhës Janar – Gusht 2025

- Raporti i shpenzimeve sipas Zërave:

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore zërat dhe realizimi (600-601) është realizuar në zbatim të strukturës organizative DAMT, ku numri i punonjësve është 5.

Nga fondi i pagave për periudhën Janar - Gusht 2025 është realizuar në vlerën 5,600 mijë lekë, ose 94 %.

Zëri për sigurime shoqërore dhe realizimi (**Art. 601**) është realizuar 794 / mijë lekë ose 87%.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime dhe realizimi, (**Art.602**), është realizuar 55/mije lekë ose 26%.

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit pranë Këshillit të Qarkut Kukës në lidhje me raportimin financiar ju informon se ky raportim është hartuar brenda standarteve ligjore, të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe legjislacioni në fuqi për financat e vetëqeverisjes vendore. Realizimi i këtij buxheti është mbështetur në transfertën e pakushtëzuar, të ardhura të trashëguara nga viti I kaluar dhe të ardhura nga DAMT (vërtetime toke).

DREJTOR

Majlinda ONUZI